



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. Prot.

Tiranë, më ; 2021

VENDIM  
Nr. 420, datë 29.09.2021

PËR  
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT , PËR  
VITIN 2019

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 "Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve" dhe nr. 264, datë 21.11.2019, "Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit", pasi shqyrtoi "Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit , për vitin 2019", i hartuar nga relatore znj. Brunilda Kadi,

V E N D O S I :

1. Miratimin e "Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit , për vitin 2019", duke e vlerësuar atë si më poshtë:
  - A. Aftësitë profesionale – "Shkëlqyeshëm";
  - B. Aftësitë organizative – "Shkëlqyeshëm";
  - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – "Shkëlqyeshëm";
  - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – "Shkëlqyeshëm".Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – "Shkëlqyeshëm".
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

## ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

### 1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy treguesve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disu nën tregues.*

#### 1-A Njohuritë ligjore.

*1-A-a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.*

Nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit, të pasqyruara edhe në raportin analitik, evidentohet se gjyqtari përkujdeset faktet dhe rrethanat e çështjes, duke i integruar me provat. Në dy vendimet e përzgjedhura nga ana e gjyqtarit konstatohet se fillimisht, pasqyrohet fakti sipas pretendimeve të palës paditëse dhe prapësimeve të palës së paditur në përputhje me provat e paraqitura prej tyre dhe të lejuara dhe të marra në shqyrtim gjatë gjyqimit. Në vijim, fakti nxirret nga ana e gjykatës, duke i bërë një cilësim pavarësisht asaj ç'ka pretendojnë palët ndërgjyqëse e që i shërben në vijim gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.<sup>1</sup> Pothuajse në të gjitha vendimet e vëzhguara, vlen të theksohet se pavarësisht natyrës së gjyqimit (*gjykim civil, familjar, seancë paraprake - dërgim çështje në gjyq apo pushim i procedimit penal*), rrethanat e fakteve parashtrihen në fillim të pjesës përshkruese - arsytuese të vendimit, pas parashtrimit të disa rrethanave procedurale dhe në përgjithësi si një nën pjesë, e titulluar "Rrethanat e çështjes".

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi konstatohet se gjyqtari tregon kujdesin e duhur, që në mbështetje edhe të nenit 16 të K.Pr.Civile, të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi në funksion të zgjidhjes së çështjes.

Në 8 vendimet e vëzhguara (6 dosjet e përzgjedhura me short dhe 2 të përzgjedhura nga vetë gjyqtari), gjyqtari përcakton qartë natyrën e çështjes objekt shqyrtimi. Gjithashtu, pas përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike, përcakton drejt edhe institutin juridik përkatës, në çështjet civile (*nëse jemi para një mosmarrëveshje juridike civile përmbushje*

<sup>1</sup>Shih për më tepër vendimet nr. 23-2019-584 (282) datë 08.04.2019 dhe nr. 23-2019-1551 (691) datë 16.09.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

detyrimi kontraktor, shuarje dorëzanie, mosmarrëveshje që lind nga cënimi i së drejtës së pronësisë, etj); në çështjet familjare (institutit i martesës, zgjidhja dhe pasojat që rrjedhin prej saj, apo instituti i mbrojtjes ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare); apo evidentimin e instituteve të reja procedurale penale si ato të seancës paraprake (nenet 329, 332 e vijues të K.Pr.Penale të ndryshuar me ligjin nr. 35/2017). Përcaktimi i qartë i natyrës së çështjes nga gjyqtari shërbën për organizimin e arsyetimit ligjor të vendimit në drejtim të indentifikimit dhe më tej argumentimit të çështjes/ve thelbësore të nevojshme për tu analizuar në raport me natyrën e çështjes.

Natyra juridike e çështjes edhe kur nuk është identifikuar në mënyrë specifike, del qartë referuar identifikimit të elementeve dhe kriterëve ligjore të mosmarrëveshjes juridike në çdo vendim gjyqësor burim vlerësimi.

Në lidhje me përcaktimin e ligjit të zbatueshëm, gjyqtari kujdeset të evidentojë qartë ligjin, duke cituar të gjitha dispozitat e tij dhe /apo akteve nënligjore që gjejnë zbatim në çështjen konkrete. Në bazë të kategorisë së çështjes objekt gjykimi, gjyqtari përcakton në fillim të pjesës përshkruese arsyetuese të vendimit, elemente që kanë të bëjnë me kompetencën (tokësore dhe lëndore pavaësisht mos citimit formal të dispozitës procedurale), juridiksionin, dhe procedurën e ndjekur nga gjykata. Më pas vijon me faktet e çështjes, sipas pretendimeve të palëve të ndërthurura me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim ose duke i integruar me provat e administruara gjatë gjykimit. Pasi përshkruan faktet e çështjes, duke cituar provat përkatëse prej të cilave rezultojnë ato, gjyqtari vijon me vlerësimin e gjykatës në të cilën gjykata merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarit dhe konkluzionin e tij. Gjyqtari paraqet dhe analizon rrethanat e faktit në mënyrë të qartë dhe mbi bazën e një renditje kronologjike. Përshkrimi i rrethanave të faktit, bëhet duke u ndërthurur me provat shkresore të marra gjatë gjykimit dhe veçimin e elementëve të faktit që rezultojnë të provuar prej tyre, duke e bërë të kuptueshëm rastin që është paraqitur për shqyrtim, ligjin e zbatueshëm dhe zgjidhjen që ka dhënë gjykata.

Gjyqtari identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në mos citimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale, të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk të referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi.

Në vendimet civile, gjyqtari identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes duke iu referuar jo vetëm dispozitave materiale të Kodit Civil dhe Kodit Familjar, por edhe ligjeve organike përkatëse (nenit 57 të K.Zgjedhor në kërkesën me objekt lejim për të votuar, apo ligjin nr. 9669 datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" i ndryshuar në çështjen me objekt lëshim i urdhrin të mbrojtjes). Në vendimet gjyqësore evidentohet citimi dhe analiza e dispozitave procedurale civile të cilat kanë lidhje, si me zgjidhjen përfundimtare të çështjes, ashtu edhe në funksion të zgjidhjes së çështjeve dhe kërkesave procedurale.

Në vendimet penale, gjyqtari identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të kodit penal, në funksion të analizës dhe vlerësimit që i bëhet shtesimit

juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit dhe ekzistencës apo jo të faktit penal në çështjet e seancave paraprake me objekt dërgimin e çështjes në gjyq apo pushimin e procedimit penal.<sup>2</sup> Në lidhje me identifikimin e dispozitave procedurale penale, në dy vendimet penale burim vlerësimi, duke u nisur nga natyra e çështjes dhe kërkesave të parashtruara nga ana e organit të akuzës/dërgim në gjyq apo pushim procedimi), gjykata identifikon dhe citon dispozitat procedurale penale, nenin 331, 332/dh/1 gërma "a" dhe gërma "c" të K.Pr.Penale në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes në lidhje me dërgimin e çështjes në gjyq dhe nenet 328 dhe 329/a në lidhje me pushimin e hetimeve.

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtari ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret, kushtëzuar kjo edhe nga natyra e çështjeve të për zgjedhura për vlerësim.

Në tërësi, referuar të dhënave që evidentohen nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësohet se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim mbi secilin fakt, citimin dhe analizën e normave respektive, analizimin nga pikpamja e ligjit dhe e provave të vendimit të dhënë nga Gjykata.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 25 pikë.

***1-A-b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.***

Nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit konstatohet se gjyqtari, referon, citon dhe interpreton normat e ligjit procedural dhe material të zbatueshëm mbi faktet e çështjes, në shërbim të analizës ligjore dhe zbatimit të tyre në zgjidhjen e çështjes konkrete.

Gjyqtari në çdo vendim citon normat ligjore në pjesën arsyetuese duke i shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes konkrete. Në pjesën e arsyetimit, bëhet vlerësimi i gjykatës mbi bazueshmërinë në ligj dhe në prova të kërtimeve objekt padie/kërkesë apo objektit të çështjes seancë paraprake. Në pjesën e vlerësimit të gjykatës, gjyqtari bën një analizë ligjore dhe interpretim të kuptimit të dispozitave të caktuara të ligjit procedural dhe material që gjejnë zbatim mbi faktin. Ky interpretim, në përgjithësi bëhet në mënyrë të pavarur dhe në raste të tjera duke u ndërthurur drejtpërdrejt me faktet e provuara në gjykim. Kjo e kushtëzuar edhe nga natyra e çështjeve të analizuara, të cilat në disa raste janë çështje jo komplekse, duke mos patur të nevojshëm interpretimin e zgjeruar të ligjit (psh. *kërkesa civile me objekt lejim për të votuar*).

<sup>2</sup>Vendimi nr. 23-2019-2335 datë 27.12.2019 dhe nr. 23-2019-1044 datë 12.06.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.





Në 8 vendimet përfundimtare të vëzhguara (*vendime civile/familjare dhe penale/seancë paraprake*), evidentohet se gjyqtari analizon dhe interpreton normat relevante që i shërbejnë zgjidhjes së çështjes jo vetëm në aspektin teorik/abstrakt të saj duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim.

Konkretisht, në disa prej vendimeve civile burim vlerësimi evidentohet se gjyqtari *interpreton*; në mënyrë abstrakte dispozitën relevante (*nenin 541 e vijues të K.Civil*) për kërkimin e kushtit penal, por edhe në lidhje me vlefshmërinë e tij duke vijuar me dhënien e argumenteve dhe analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjet e shtruar për zgjidhje në përputhje me normën relevante për zbatim, dhe në fund jep konkluzionin e arritur: dispozitën relevante (*nenin 600 të K.Civil*) mbi shuarjen e dorëzarisë dhe zgjidhjen e pasojave, interpretim i bërë në mënyrë sistematike me dispozitat e tjera të K.Civil dhe ligjeve të posaçme (*kodi i procedurës civile mbi titujt ekzekutiv si dhe ligji për sistemin hankar*), në mënyrë koherente, logjike dhe historike; në mënyrë teleologjike dhe literale, nenin 296 dhe 302 të K.Civil në lidhje me paditë reale për mbrojtjen e pronësisë, duke identifikuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen dhe pas interpretimit teorik që i bëhet dispozitës relevante zbatuese, gjykata i analizon këto kritere në përputhje me faktin juridik dhe provat e administruara në gjykim, etj.

Në dy vendimet penale burim vlerësimi (*seancë paraprake - dërgim në gjyq dhe pushim procedimi penal*), gjyqtari ndalet në interpretimin e dispozitave procedurale penale të ndryshuara me ligjin 35/2017 në funksion të zgjidhjes së çështjes. Interpreton dispozitat procedurale penale të ndryshuara (*nenet 332 e vijues të K.Pr.Penale – mbi dërgim e çështjes në gjyq*) mbi qëllimin, funksionin dhe detyrat e gjyqtarit të seancës paraprake në lidhje me konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve procedurale, papërdorshmërinë e provave apo mjaftueshmërisë së provave për të mbështetur akuzën dhe nëse hetimet e kryera nga ana e organit të akuzës janë të plota dhe të gjithëanshme; interpreton dispozitat procedurale penale të ndryshuara (*nenet 328, 329/a e vijues të K.Pr.Penale – mbi pushimin e akuzës apo të çështjes penale*) mbi qëllimin, funksionin dhe detyrat e gjyqtarit të seancës paraprake në rastet kur organi i akuzës ka proceduar mbi pushimin e çështjes penale apo të akuzës konform nenit 328 të K.Pr.Penale.

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi, konstatohet se analiza ligjore përbën një rrjedhë logjike midis fakteve, interpretimit të ligjit, aplikimit të tij mbi faktin konkret dhe konkluzioneve të arritura nga gjyqtari.

Në disa prej vendimeve të analizuara, rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjeve të Gjykatës së Lartë, si dhe vendime të Gjykatës Kushtetuese*) në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij. Konkretisht gjyqtari citon: *vendimin nr. 509/2015 të Gjykatës së Lartë në lidhje me natyrën juridike të kushtit penal, vendimin unifikues nr. /2012 i Gjykatës së Lartë në lidhje me pasojat e pavlefshmërisë së veprimit juridik, vendimin unifikues nr. 13/2004 dhe vendimin nr. 229/2014 të Gjykatës së Lartë.*

*vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 39/2007 në lidhje me dhënien e kredive bankare, vendimin unifikues nr. 5/2011 si dhe vendimin unifikues nr. 1/2009 të Gjykatës së Lartë në lidhje me paditë për mbrojtjen e të drejtave reale, padine e rivendikimit, etj.*

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, në çdo rast janë respektuar me korrektësi aspektet e parimit të procesit të rregullt ligjor. Në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi gjyqtari citon nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së në lidhje me të drejtën e pronës si dhe parimin procedural të një procesi të rregullt ligjor: zbaton parimet e së drejtës, në lidhje me të drejtën për jetë familjare e duke eitur për këtë qëllim dispozitat përkatëse në të cilën ajo parashikohet në nenin 53 të Kushtetutës, nenin 8 të KEDNJ-së si dhe Konventën e Këshillit të Europës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje", etj.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësohet se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për të interpretuar ligjin në funksion të zgjidhjes së çështjes. Në vendimet përfundimtare të analizuara, gjyqtari në disa raste dhe kur është e vlerësuar e nevojshme, ka interpretuar dispozita të akteve ligjore dhe nënligjore, me natyrë procedurale dhe materiale, duke referuar në disa raste edhe në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi :** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 25 pikë.

## **I-B Arsyetimi ligjor**

### ***I-B-a Qartësia, konçiziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se vendimet gjyqësore janë përgjithësisht të qarta dhe të kuptueshme, kjo jo vetëm për njohësit e ligjit. Gjyqtari përdor fjalë me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë. Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe shmang përdorimin e fjalëve fyese apo denigruese. Përdor të gjitha shkronjat e alfabetit shqip (*gjithmonë konstatohet përdorimi i shkronjës "ç" dhe "ë"*). Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në ligjet e posaçme të përdoruara nga ana e gjykatës në lidhje me ligjin e zbatueshëm, apo në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalëve me gjatësi normale, të ndërthurura dhe të kuptueshme. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra-tjetrës dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit të cilin përdoren. Megjithatë, në disa raste evidentohet përdorimi i fjalëve që nuk i përshtaten formatit të një dokumenti zyrtar.

është një vendim gjyqësor, si p.sh: “ gjykata *operoi* me vendim të ndërmjetëm” (vendimi civil nr. 1759/2019), “ nuk është paraqitur *fare* për ekzaminim” (vendimi penal nr.2335/2019). “ Pjesa tjetër *ngelet* në ngarkim të të paditurit” (vendimi civil nr.1353/2019).  
Vendimi përgjithësisht është i organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër dhe në disa raste edhe duke e numërtuar.

Në vendimet përfundimtare të vëzhguara, evidentohet që gjyqtari bën edhe interpretim abstrakt të ligjit, ndonjëherë edhe të panevojshëm. Gjithashtu në pjesën hyrëse të arsytimit, gjithmonë parashtrohen elementë proceduralë si kompetenca, juridiksioni, të cilat, nisur nga përmbajtja e vendimit, nuk kanë qënë të diskutueshme nga palët apo rrethanat. Në disa raste cifon përmbajtjen e të gjithë dispozitës, ndonjëherë edhe të panevojshme. Prezenca e të gjithë këtyre elementëve, vlerësoj se cënon qartësinë dhe konçizitetin e vendimit.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 12 pikë.

#### ***I-B-b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.***

Gjyqtari në hartimin e vendimit ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar. Ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese - arsytuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

*Në pjesën hyrëse* gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, si dhe kërkimet e subjekteve të pranishme në proces.

*Pjesa përshkuese arsytuese* është e ndarë në disa pjesë dhe gjithashtu të listuara formalisht si: “Procedura”; “Rrethanat e faktit” apo “Vlerësimi dhe analiza juridike”, në të cilën në mënyrë të detajuar analizon:

- procedurën, në të cilën shkurtimisht ndalet në disa rrethana procedurale në lidhje me juridiksionin dhe kompetencën, gjykimin në mungesë të palëve, kërkesat për sigurimin e padisë, etj.

- rrethanat e fakteve të çështjes. Gjyqtari e përshkruan faktin në fillim të pjesës përshkuese - arsytuese, fakt i nxjerrë kryesisht nga ajo ç`ka pretendojnë palët ndërgjyqëse në proces sipas pretendimeve të palës paditëse dhe prapësimeve të palës së paditur në përputhje me provat respektive të paraqitura prej tyre dhe të lejuara dhe të marra në shqyrtim gjatë gjykimit. Në vijim, konstatohet se fakti juridik nxirret dhe pasqyrohet nga ana e gjykatës kur i bën cilësim faktit. pavarësisht asaj ç`ka pretendojnë palët ndërgjyqëse e që i shërben në vijim gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

- vlerësimi i gjykatës, në të cilën merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarit dhe konkluzionin e tij.

*Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore, e drejta dhe afati i ankimit dhe data e shpalljes së vendimit. Gjyqtari përdor teknikën e listimit të disponimeve duke i numërtuar ato, që lehtëson referencat në rastin kur vendimi ka disa disponime.*

Konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile, në vendimet familjare dhe civile, nenin 332/e të K.Pr.Penale në vendimet seancë paraprake, apo te ligjit 9669/2006 i ndryshuar në çështjet me objekt lëshimin e urdhrit të mbrojtjes.

Vendimet janë të strukturuar në paragrafe, me qëllim që palët të kuptojnë konkluzionin dhe arsyetimin e gjykatës për çdo pretendim të ngritur, në funksion të vendimmarrjes përfundimtare. Gjyqtari ndjek rregulla të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor, identifikon faktet, provat, argumentimin ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm, dhe konkluzionin e arritur.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi :** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 10 pikë.

#### ***I-B-c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.***

Në vendimet gjyqësore të vëzhguara konstatohet se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në drejtim të analizës dhe argumentimit logjik. Gjyqtari, identifikon dispozitat ligjore, shtjellon argumentat e gjykatës në mënyrë llogjike, duke paraqitur një analizë të plotë të fakteve të çështjes, së bashku me provat mbi të cilat ato mbështeten, si dhe paraqet argumentat në lidhje me bazueshmërinë ose jo të kërkimeve objekt gjykimi.

Në shumicën e vendimeve, posaçërisht në vendimet e themelit, gjyqtari analizon dhe lidh në mënyrë të drejtpërdrejtë kërkimet objekt padie ose pretendimet e palës së paditur, me faktin e provuar në gjykim si dhe me argumentin ligjor konkret, duke evidentuar lidhjen mes fakteve të provuara në gjykim me konkluzionin në lidhje me bazueshmërinë ose jo të pretendimeve nga pikpamja ligjore. Gjithashtu, në çështjet penale, referuar natyrës së tyre (seancë paraprake), gjyqtari analizon faktin penal duke e lidhur drejtpërdrejt me elementët e figurës së veprës penale apo kushtet procedurale për dërgimin e çështjes në gjyq, apo të pushimit të procedimit penal. Ai argumenton në mënyrë llogjike përfaqshjen e fakteve të provuara në gjykim, me ligjin e zbatueshëm, kuptimin e tij nëpërmjet interpretimit dhe duke identifikuar lidhjen shkak-pasojë, mes faktit, ligjit dhe konkluzionit në zgjidhjen e çështjes.

Gjyqtari në çdo rast ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi duke orientuar dhe analizën e koncepteve ligjore (si psh, të kushtit penal gjobor apo disiplinor, dorëzimit dhe afatit prekluziv të saj, të padive reale për mbrojtjen e pronësisë, si padia mohuese dhe ajo e rivendikimit, konceptit dhumë në marrëdhëniet familjare dhe mënyrës së parandalimit dhe mbrojtjes ndaj saj, seanca paraprake, detyrat e



*gjyqtarit të seancës paraprake, etj), në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes.*

Gjithashtu evidentohet se gjyqtari i kushton rëndësi analizës së instituteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezulton e nevojshme psh: institutit të martesës dhe shkaqet që të çojnë në zgjidhjen e saj si dhe zgjidhjen e pasojave ligjore që rrjedhin prej saj; institutit të lindjes së detyrimeve kontraktore, analiza e të drejtave dhe detyrimeve në këtë marrëdhënie juridike civile të krijuar ndërmjet palëve; institutit procedural të seancës paraprake, si një institucion i ri procedural / fazë e parashikuar për herë të parë në Kodin e Procedurës Penale me ndryshimet e ligjit 35/2017, duke përcaktuar plotësimin e detyrimeve ligjore nga ana e organit të akuzës për dërgimin e çështjes në gjyq, qëllimin dhe funksionin e këtij instituti, si dhe detyrat e gjyqtarit të seancës paraprake.

Gjyqtari evidenton në mënyrë të kuptueshme normën ligjore të zbatueshme, duke dhënë arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në çdo rast konkret. Dispozitat ligjore që gjejnë zbatim në çështjet konkrete, jo vetëm referohen ose citohen kur është e nevojshme, por edhe analizohen dhe interpretohen në raport me faktet e çështjes apo me kërkimet e palëve në gjykim. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë, merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi :** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, duhet të vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
97	Shkëlqyeshëm

## 2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.*

### 2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

#### 2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton që gjyqtari ka përfunduar gjithsej 144 çështje për të cilat parashikohet afat ligjor, nga të cilat 12 prej tyre kanë përfunduar tej këtij afati. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (12 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat ligjor (144 çështje), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar vetëm 8.96 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 15 pikë.

#### *2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.*

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka gjykuar në total 400 çështje për të cilat janë parashikuar afate orientuese për standardin minimal, prej të cilave 58 janë jashtë këtij afati, ose 14.5 % e tyre.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, gjyqtari ka bërë prezent një sërë shkaqesh të cilat kanë ndikuar në kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve të cilat janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në Raportin Analitik.

Për të vlerësuar këtë tregues, sipas metodologjisë së miratuar nga Këshilli, këto të dhëna statistikore duhet të analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Respektimi i këtyre afateve, jo gjithmonë është i varur nga gjyqtari.

Konkretisht, në tabelën nr. 1, *Çështje civile të përgjithshme me palë kundërshtare*, gjyqtari në Formularin e Integruar të Vlerësimit, ka evidentuar faktin se në këtë tabelë, 4 gjykime me objekt « pjestim pasurie », janë gjykuar jashtë standardit minimal kohor, duke parashtruar arsyet: *gjykimi është zhvilluar në 2 faza dhe është vonuar marria e formës së prerë të vendimit të ndërmjetëm të fazës së parë, si pasojë e ankimimit të palëve në Gjykatën e Apelit.*

Gjithashtu, duke analizuar të dhënat statistikore, rezulton se për disa çështje, kalimi i afatit të standardit minimal kohor, është i papërfillshëm (kohës relativisht të shkurtër të kalimit të këtij afati) e konkretisht:

-Tabela nr. 1 "*Civile të përgjithshme me palë kundërshtare*", çështja me nr. rendor 33, është gjykuar për 185 ditë, vetëm 5 ditë në tejkalim të afatit.

-Tabela nr. 2 "*Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*", çështja nr. rendor 6 është gjykuar për 72 ditë, vetëm 12 ditë në tejkalim të afatit, çështja nr. rendor 93 është gjykuar për 66 ditë, vetëm 6 ditë në tejkalim të afatit, çështja me nr. rendor 95 është gjykuar për 96 ditë, vetëm 6 ditë në tejkalim të afatit dhe çështja me nr. rendor 97, është gjykuar për 63 ditë, vetëm 3 ditë në tejkalim të afatit.

-Tabela nr. 3 "*Familjare me palë kundërshtare*", çështja me nr. rendor 6 dhe 24, janë gjykuar për 127 ditë, vetëm 7 ditë në tejkalim të afatit, çështja nr. rendor 46, është gjykuar për 123 ditë, vetëm 3 ditë në tejkalim të afatit.

-Tabela nr. 9 "Penale kundërvajtje", çështja me nr. rendor 26 është gjykuar për 127 ditë, vetëm 7 ditë në tejkalim të afatit dhe çështja me nr. rendor 33 është gjykuar për 128 ditë, vetëm 8 ditë në tejkalim të këtij afati.

Nëse nga numri i përgjithshëm i çështjeve të gjykuara jashtë standardit minimal kohor, do të zbrisnim 13 çështjet e sipërcitura, do të rezultonte se gjyqtari ka gjykuar 45 nga 400 çështje në total, jashtë afatit standard minimal kohor, ose 11.2 % të tyre.

Duke marrë parasysh edhe:

a) kohën që i është dashur gjyqtarit për shtyrje të gjykimit për shkaqe të pavarura prej tij siç është njoftimi dhe respektimi i të drejtave të tjera të palëve,

b) ngarkesën e gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit, nga ku rezulton se ai ka gjykuar mbi 50% më shumë se numri i çështjeve, sipas standartit minimal sasior të punës, të përcaktuar në vendimin nr. 261/2, dt 14.04.2010, të KLD-së, duke patur parasysh që gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtari ka ushtruar edhe funksionin e zv.kryetarit të gjykatës,

vlerësoj se gjyqtari në lidhje me këtë kriter duhet të pikëzohet në nivelin maksimal të tij.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 5 pikë.

#### **2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje.**

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se në total, gjyqtari ka gjykuar në cilësinë e relatorit 533 çështje (standard minimal kohor), nga të cilat:

1. 63 (gjashtëdhjetë e tre) çështje civile të kategorisë "civile të përgjithshme me palë kundërshtare", koha mesatare rezulton të jetë 202.9 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së

2. 181 (njëqind e tetëdhjetë e një) çështje civile të kategorisë "civile të përgjithshme pa palë kundërshtare", koha mesatare rezulton të jetë 21.7ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej 2 (dy) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së

3. 43 (dyzet e tre) çështje të kategorisë "familjare me palë kundërshtare", koha mesatare rezulton të jetë 80.5 ditë pra më e shkurtër se afati 4 (katër) muaj i parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së.

4. 3 (tre) çështje të kategorisë "familjare pa palë kundërshtare" koha mesatare rezulton të jetë 81.3 ditë pra më e gjatë se afati standard minimal kohor prej 2 (dy) muaj i parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së.

5. 3 (tre) çështje të kategorisë "marrëdhënie pune", koha mesatare rezulton 102.6 ditë pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së.

6. 28 (njëzet e tetë) çështje të kategorisë "penale krime", koha mesatare rezulton 40.6 ditë pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 9 (nëntë) apo 12 (dymbëdhjetë) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së.

7. 38 (*tridhjetë e tetë*) çështje të kategorisë "*kumdravajtje penale*" koha mesatare rezulton 39.2 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 4 (katër) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së.

8. 39 (*tridhjetë e nëntë*) çështje të kategorisë "*seanca paraprake me objekt pushim procedimi*", koha mesatare rezulton 50.5 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 2 (dy) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së.

9. 2 (*dy*) çështje të kategorisë "*kërkesa penale në fazën e ekzekutimit*", koha mesatare rezulton 61 ditë, pra sa standardi minimal kohor prej 2 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së.

Sipas metodologjise, nga leximi *i thjeshtë* i të dhënave statistikore, në këtë rast vlerësimi i aftësisë të gjyqtarit do të ishte në shkallën mbi mesatare, duke e pikëzuar me 4 pikë. Kjo pasi, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është *më e shkurtër* se standarti minimal kohor për shumicën e kategorive të çështjeve, e konkretisht për 2 nga 9 kategoritë.

Duke analizuar të dhënat statistikore për çdo çështje, sipas arsytimit të bërë edhe në treguesin më lart, *2.A.b*, nga kjo periudhë duhet të zbriten koha që i është dashur gjyqtarit për shtyrje të gjyqimit për shkaqe të pavarura prej tij si ; *njoftimi dhe respektimi i të drejtave të tjera të palëve, pushimet vjetore gjatë muajit Gusht, festat zyrtare gjatë muajit Dhjetor dhe Janar.*

Gjithashtu, në këtë analizë duhet patur parasysh edhe: a) diferenca e vogël në kohë dhe, b) ngarkesën e gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit, nga ku rezulton se ai ka gjykuar *mbi 50% më shumë* se numri i çështjeve, sipas standartit minimal sasior të punës, të përcaktuar në vendimin nr. 261/2, dt 14.04.2010, të KLD-së, duke patur parasysh që gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtari ka ushtruar dhe funksionin e zv.kryetarit të gjykatës.

Nisur nga kjo analizë, vlerësoj që koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, është më e shkurtër ose e barabartë me standardin minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve dhe për këtë arsye, gjyqtari për këtë tregues vlerësohet në nivelin maksimal.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "*Shumë e lartë*", duke e pikëzuar me 5 pikë.

#### *2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se gjyqtari ka përfunduar si relator 534 çështje nga 610 çështje që i janë caktuar gjithsej gjatë vitit të vlerësimit. Nga këto të dhëna del që rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore nga gjyqtari për periudhën e vlerësimit në total është 89 %, e që sipas metodologjisë do të vlerësohej në nivelin mesatar, duke u pikëzuar me 6 pikë.

Në Formuarin e Vlerësimit gjyqtari ka parashtruar se *shkalla e aftësisë për këtë tregues duhet të kategorizohet shumë e lartë, pasi në uljen e rendimentit ka ndikuar rritja e numrit të çështjeve në vitin 2019 për shkak të largimit të disa gjyqtarëve në Gjykatën e Rrethit*



Gjyqësor Sarandë. Sipas pretendimeve të gjyqtarit, vetëm në datë 18.12.2019 ka marrë në short 47 çështje të gjyqtares K.B që ka dhënë dorëheqjen duke rritur numrin në mënyrë të menjëhershme në muajin Dhjetor 2019. Nga të dhënat statistikore rezulton se gjyqtari ka përfunduar gjatë periudhës së vlerësimit një numër relativisht të konsiderueshëm çështjesh (në total ka përfunduar 543 çështje si relator), nga të cilat 254 çështje të të gjitha kategorive, me palë kundërshtare. Gjithashtu duke iu referuar pretendimeve të ngritura nga ana e gjyqtarit në lidhje me rritjen e ngarkesës së punës me largimin e gjyqtarëve të tjerë të kësaj gjykate, si dhe faktit që gjyqtari ka përfunduar mbi 50 %, më shumë nga standardi minimal i ngarkesës, ky rendiment pikëzohet një nivel më lart nga pikëzimi që i takon rendimentit 89 %, e konkretisht në nivelin mbi mesatar duke pikëzuar me 8 pikë.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet "Mbi mesataren", duke e pikëzuar me 8 pikë.

#### *2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.*

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor nga ana e gjyqtarit, është më e shkurtër se afati procedural, për shumicën e kategorive të çështjeve. Ndërkohë, duke qënë se ky afat është kapërcyer vetëm për një nga 16 kategoritë e çështjeve, dhe kjo vetëm për 4 ditë, si dhe duke patur parasysh ngarkesën që ka përballuar gjyqtari gjatë kësaj periudhë, pikëzimi për këtë tregues duhet të jetë maksimal.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 15 pikë.

#### **2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.**

##### *2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerju e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive.*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton të jetë gjeneruar numri i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh. Ndërkohë, referuar 6 çështjeve të përzgjedhura me short (me palë kundërshtare) rezultojnë këto të dhëna në lidhje me numrin mesatar të seancave gjyqësore: 2.5 seanca gjyqësore për çështjet e kategorisë «familjare me palë kundërshtare» (duke përjashtuar seancat e pajtimit në të dyja çështjet objekt vlerësimi), 2.5 seanca gjyqësore për çështjet e kategorisë «seancë paraprake» (dërgim në gjyq apo pushim procedimi penal) dhe 2 seanca gjyqësore për çështjet e kategorisë «civile me palë kundërshtare» (duke përjashtuar seancat përgatitore). Në tërësi, nga vëzhgimi i 6 dosjeve burim vlerësimi, dhe duke mbajtur në konsideratë se është përgjegjësi e gjyqtarëve të sigurojnë dhe të bëjnë çmos për të shmangur çdo vonesë të panevojshme, vlerësohet se gjyqtari: ka ndërmarrë një rol të vëmendshëm në planifikimin në kohë të çështjeve, duke i vënë në lëvizje menjëherë ose deri në 1 ditë pas caktimit të tij si

relator i çështjes, në vendimin e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, gjyqtari ka marrë masat për njoftimin në mënyrë efektive të palëve si me fletëthirrje për palët, me shkresa drejtuar institucioneve përkatëse, apo edhe nëpërmjet mënyrave të tjera të parashikuara nga K.Pr.Civile i ndryshuar, në asnjë rast nuk rezulton që seanca të jetë shtyrë për shkak të gjyqtarit, por gjithmonë për shkaqe procedurale dhe në funksion të një procesi të rregullt ligjor, konstatohet që seancat pothuajse gjithmonë kanë filluar në kohë dhe pa vonesë.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 15 pikë.

**2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.**

Referuar: a) analizës së çështjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, nga të cilat evidentohet se: gjyqtari në të gjitha çështjet e ka vënë në lëvizje dosjen në kohë dhe në përputhje me afatet ligjore, ka kryer veprimet procedurale të nevojshme për kryerjen e veprimeve përgatitore efektive dhe në kohë, si njoftimin e akteve palës së paditur, apo deklaratën e mbrojtjes palës paditëse, planifikimi dhe zhvillimi i seancave përgatitore efektive, të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara në dosje, drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt dhe është shprehur me urdhra dhe vendime të ndërmjetme për çdo kërkesë të palëve ndërgjyqëse, ndjek me rigorozitet të gjitha fazave në të cilat kalon shqyrtimi gjyqësor, seancat kanë filluar në përgjithësi pa vonesë, dhe në ato raste në të cilat ka pasur vonesa, është relatuar gjithmonë arsyeja, seancat gjyqësore janë të regjistruara audiodhe b) burimeve të tjera të vlerësimit, evidentohet se nga ana e gjyqtarit janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 20 pikë.

**2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.**

**2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.**

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se nga ana e gjyqtarit renditja e akteve të dosjes gjyqësore është në atë mënyrë që e bën dosjen lehtësisht të shfrytëzueshme.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 5 pikë.

**2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.**

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet që dokumentacioni në dosje, është në përputhje me veprimet procedurale të kryera, nuk ka mungesa, dhe se është i duhuri.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
98	Shkëlqyeshëm

### 3.ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLFRAVE PROFESIONALE

*Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.*

#### 3.A Etika në punë

##### 3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** evidentohet të ketë të dhëna që mund të tregojnë cënim të etikës apo përgjegjshmërisë në ushtrimin e funksionit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërbajtje, ndjeshmërie, vëmendje, apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarit, gjatë ushtrimit të funksionit.

**Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e etikës së gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 35 pikë.

#### 3.B Integriteti i gjyqtarit

##### 3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjtëti.

The bottom of the page contains several handwritten signatures and initials in black ink. There are approximately seven distinct marks, some appearing to be full names and others as initials or abbreviations. The handwriting is cursive and somewhat stylized.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të integritetit si dhe **nuk** rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që çenojnë nderin dhe dinjitetin e tij.

**Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e integritetit të gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 40 pikë.

### 3.C Paanësia e gjyqtarit

#### 3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese

Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** rezulton që gjyqtari, të ketë përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit si dhe në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 10 pikë.

#### 3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se për periudhën 01 janar 2019 – 31 Dhjetor 2019, për gjyqtarin Sokol Pina janë paraqitur 4 (katër) kërkesa të cilat janë rrëzuar. Nga ana tjetër, rezulton se vetë gjyqtari ka paraqitur 18 kërkesa për heqje dorë nga të cilat janë pranuar 16 prej tyre.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

## 4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

*Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.*



#### 4.A Aftësia e komunikimit.

##### *4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.*

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent, me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 25 pikë.

##### *4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.*

Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve, apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

**Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 15 pikë.

#### 4.B Aftësia për të bashkëpunuar

##### *4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.*

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, prezumohet se ai ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 15 pikë.

##### *4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.*

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, prezumohet se ai ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 10 pikë.

#### 4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

##### *4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.*

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari gjatë vitit 2019, ka marrë pjesë në programet e formimit vazhdues me cilësinë e pjesëmarrësit. konkretisht, gjyqtari ka qënë pjesëmarrës në 5 trajnime, përgjatë 7 ditëve. Kjo kohëzgjatje është brenda kufijve 5 deri në 40 ditë, në periudhën njëvjeçare të vlerësimit.

**Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtari vlerësohet me 20 pikë.

##### *4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.*

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezultojnë të ketë të dhëna që gjyqtari përgjatë vitit kalendarik 2019, të ketë udhëhequr kandidatët për magjistratë gjatë stazhit profesional apo të ketë qënë në rolin e ekspertës/lehtësueses për trajnimin e gjyqtarëve.

Gjyqtari në formularin e integruar të vlerësimit ka shpjeguar se: *me vendimin përkatës të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, i marrë në vitin 2019, është përfshirë në listën e lehtësuesve të aktiviteteve trajnuese për Programin e Formimit Vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020. Sipas tij është caktuar si lehtësues në programin e trajtimit vazhdues, në temën: "Mbrojtja penale e mjedisit. Probleme të praktikës gjyqësore" të cilën e ka pranuar dhe e ka zhvilluar temën përkatëse.*

Në lidhje me sa më sipër pretenduar, nuk rezultojnë që gjyqtari të ketë përcaktuar se kur është zhvilluar trajnimi në të cilën ka qënë me cilësinë e lehtësuesit. Duke iu referuar edhe shkresës të paraqitur nga Shkolla e Magjistraturës me nr. 47 prot., datë 13.01.2021, sipas së cilës rezultojnë se *për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2019 gjyqtari Sokol Pina nuk është ftuar për të marrë pjesë në cilësinë e lehtësuesit/ekspertit në aktivitetet trajnuese*, nuk provohet se gjatë vitit të vlerësimit gjyqtari të ketë dhënë këtë kontribut.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se : *për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtarin Sokol Pina, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.*

**Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtari vlerësohet me 3 pikë.

g/b  
f  
c/g  
21  
Lush.  
K. V.  
Sub

**4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitutionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari të marrëdhëniet me publikun në gjykata.**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se për periudhën e vlerësimit, për gjyqtarin nuk evidentohen të dhëna në lidhje me këtë tregues.

Gjyqtari në formularin e integruar të vlerësimit ka shpjeguar se *gjatë vitit 2019 ka marr pjesë rregullisht dhe aktivisht në takimet e drejtuesve të gjykatave të organizuar nga Projekti Drejtësi për të Gjithë i USAID. Në këto takime diskutoheshin problematika të ndryshme ligjore që lidheshin me funksionimin e gjykatave në përgjithësi, por edhe "projekt vendimet" e Këshillit të Lartë Gjyqësor, etj.*

Në lidhje me këtë pretendim, pavarësisht disponueshmërisë dhe qënies prezent në takimet e drejtuesve të gjykatave të organizuar nga Projekti Drejtësi për të Gjithë i USAID, nuk konstatohet e materializuar apo e dokumentuar me ndonjë provë dhënia e ndonjë kontributi nga ana e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitutionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë. Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se *për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari,* për gjyqtarin Sokol Pina, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

**Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtari vlerësohet me 3 pikë.

**4.C.ç Publikimet ligjore akademike.**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk evidentohet asnjë publikim ligjor i realizuar nga gjyqtari gjatë vitit 2019.

**Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtari vlerësohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
91	Shkëlqyeshëm

**NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT**

<b>Niveli i vlerësimit për çdo kriter</b>		
<b>Kriteri</b>	<b>Pikët</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	97	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	98	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
<b>Niveli i përgjithshëm të vlerësimit</b>		
Vlerësimi i përgjithshëm	386	Shkëlqyeshëm

**PROPOZIME DHE REKOMANDIME**

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja "ç" të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuarra dhe vlerësuarra në raport me kriteret e vlerësimit, Këshilli i rekomandon gjyqtarit Sokol Pina:

1. të angazhohet në rritjen, edhe më shumë, të aftësive të tij profesionale dhe organizative
2. të mbajë në konsideratë angazhimin e tij në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**





SHTOJCA 1

\* KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE NIVELI I VLERËSIMIT, PËR PERIUDHËN E VLERËSIMIT 01.01.2019-31.12.2019 I GJYQTARIT

1. AFTËSITË PROFESIONALE			Pikët total	Niveli i vlerësimit	
			97	Shkëlqyeshëm	
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë	
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë

Handwritten signatures and initials at the bottom of the page, including a large signature on the left, a signature in the center, and several initials on the right.

					Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
<b>B. Arsyetimi ligjor</b>	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarët 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarëve 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Mbi mesataren	12	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarëve:</b>  E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarët 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarëve 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarëve:</b>  E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarët 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarëve 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarëve:</b>  E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
<b>1. AFTËSITË ORGANIZATIVE</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				98	Shkëlqyeshëm
<b>Tregues</b>	<b>Burimet</b>	<b>Shkalla e</b>	<b>Pikët</b>	<b>Metodologjia</b>	

			<b>aftësisë/niveli i treguesit</b>		
<b>A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë</b>	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	15	<b>Jashtë afatit:</b> Mbi 40 %- 3 pikë 31-40 %- 6 pikë 21-30 %- 9 pikë 11-20 %- 12 pikë 0-10 %- 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	5	<b>Jashtë afatit:</b> Mbi 40 %- 1 pikë 31-40 %- 2 pikë 21-30 %- 3 pikë 11-20 %- 4 pikë 0-10 %- 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	5	<b>Koha mesatare:</b> Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë









					me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Mbi mesatare	8	<b>Tej standardit :</b> Nën 81 %- 2 pikë Mbi 81-87 % - 4 pikë Mbi 87- 93 % - 6 pikë Mbi 93-99 % - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	15	<b>Koha mesatare:</b> Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
<b>B. Aftësia e gjyqtarit për të</b>	a. Numri mesatar i seanceve gjyqësore për çdo çështje dhe	1. Të dhënat statistikore/aktet e	Shumë e lartë	15	<b>Numri mesatar i seanceve dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b>



kryer procedural gjyqësore	kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit			Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallëmesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	20	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	5	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE			Pikët total	Niveli i vlerësimit
			100	Shkëlqyeshëm
Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
<b>A. Etika në punë</b>	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë  35	<b>Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit:</b> E dobët - 7 pikë Nën mesataren - 14 pikë Mesatare - 21 pikë Mbi mesataren - 28 pikë Shumë e lartë - 35 pikë
<b>B. Integriteti i gjyqtarit</b>	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë  40	<b>Shkalla e integritetit të gjyqtarit :</b> E dobët - 0 pikë Shumë e lartë - 40 pikë
<b>C. Paanësia e gjyqtrit</b>	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë  10	<b>Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese:</b> E dobët - 2 pikë Nën mesataren - 4 pikë Mesatare - 6 pikë

		për vlerësim			Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Nuk ka asnjë kërkesë të pranuar të palëve për përjashtim gjyqtari	15	<b>Numri i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit:</b>  Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
<b>4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				91	Shkëlqyeshëm
<b>Tregues</b>		<b>Burimi</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>	<b>Pikët</b>	<b>Metodologjia</b>
<b>A. Aftësia e komunikimit</b>	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë	25	<b>Qartësia dhe transparenca e komunikimit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura	I Lartë	15	<b>Respektimi i konfidencialitetit:</b> I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë

		nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short			I lartë – 15 pikë
<b>B. Aftësia për të bashkëpunuar</b>	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	15	<b>Shkalla e komunikimit:</b> E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e komunikimit:</b> E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
<b>C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera</b>	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtari	Mbi 5 ditë (për periudhën 1 vjeçare)	20	<b>Pjesëmarrja e gjyqtarit:</b> (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Nuk ka të dhëna		3

8



	c. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarit 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarit	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pike Ka të dhëna – 5 pike
	ç. Publikimi ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të tij	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pike Ka të dhëna – 1 deri në 5 pike
<b>PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT</b>			<b>386</b>		
<b>NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT</b>			<b>Shkëlqyeshëm</b>		

RELATOR

BRUNILDA KADI